



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 nën c. nenit 52 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, nenit 10 nën pikën 3, dhe 18 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e V-të të rregullt, të mbajtur më 30.05.2014, mori këtë:

V E N D I M

Për

Lëshuarje në diskutim publik të ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores komunale për përcaktimin e tarifave ngarkesave, dhe gjobave komunale të Janarit të vitit 2012

I

Lëshohet në diskutim publik, Ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores për përcaktimin e tarifave, ngarkesave dhe gjobave komunale.

II

Ndryshimet dhe plotësimet si në pikën 1 të këtij Vendimi lëshohen në diskutim publik 15 ditë prej ditës së shpalljes në tabelën e shpalljeve dhe ueb faqen e Komunës.

III

Brenda 15 ditëve të diskutimit publik të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës, personat fizikë dhe juridikë dhe organizatat e biznesit, si dhe të gjithë të interesuarit mund të marrin tekstin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullorës në Zyrën ligjore në objektin e Komunës, si dhe vërejtjet dhe sugjerimet me shkrim mund të jepën pranë kësaj zyre.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës.

V

Vendimi është transparent përmes: Tabelës së shpalljeve, Zyrës për Informim, Zyrës Ligjore dhe Radio-“ALBA”.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01 Nr. 06-3141/2014
Klinë, më 03.06, /2014

Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi

